



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË
INSPEKTORIATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Nr. 1323/1 Prot.

Tiranë, më 24.07. 2015

Lënda : Kthim përgjigje

Drejtuar: Znj. Diana Toma
Presidentë
Urdhri i Farmacistëve

TIRANË

E nderuar Znj.Toma,

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 511 prot, datë 20.07.2015 me anë të së cilës kërkonti interpretim ju sqarojmë si më poshtë:

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH), në përputhje me Ligjin Nr.9634, datë 30.10.2006 “Për Inspektimin e Punës”, i ndryshuar, kontrollon dhe siguron respektimin dhe zbatimin e Legjislacionit të Punës.

Në kuptim të neneve 78 dhe 90 të Ligjit Nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i RSH-së, i ndryshuar, kohëzgjatja ditore normale e punës është jo më shumë se 8 orë dhe numri maksimal i orëve shtesë është 50 orë pune në javë.

Përcaktimet ligjore të mësipërme si dhe akte të tjera të veçanta normative sqarojnë se se dy-punësimi me **kohë të plotë** nuk lejohet në asnjë rast.

Duke vazhduar sqarimin e mësipërm, një person mund të punojë në një subjekt të dytë për aq orë sa nuk tejkalohet numri maksimal i orëve shtesë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYEINSPEKTORI

Dritan VLLI

